

BULETINI INFORMATIV



Gjatë muajit shkurt, ERE ka vijuar ushtrimin e veprimtarisë së saj rregullatore dhe vendimmarrëse në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror. Në këtë përmbledhje mujore do të gjeni informacion mbi licencimet e reja, publikimet, të dhënat e tregut, çmimet e shitjes së energjisë elektrike si dhe dokumentet/aktet rregullatore që ndodhen në proces konsultimi publik.

Synimi ynë mbetet garantimi i transparencës, rritja e eficiencës dhe mbështetja e zhvillimit të tregut të energjisë në vend.

Për më shumë detaje, vendimet dhe dokumentet e plota mund t'i shfletoni në faqen tonë zyrtare: www.ere.gov.al

Vendimmarrjet e Bordit të ERE gjatë muajit shkurt

Gjatë muajit shkurt 2025, Bordi i ERE ka zhvilluar 5 mbledhje vendimmarrëse për të cilat është bërë njoftimi të paktën 24 orë përpara edhe në rrjetet sociale të institucionit, duke ftuar të gjitha palët e interesit të ndjekin mbledhjet online. Në këto mbledhje u shqyrtuan dhe miratuan 36 vendime, që përfshijnë: fillimin e procedurave të reja të licensimit; licensime; autorizime; pezullim apo zgjatje të afateve vendimmarrëse; heqje licence si dhe miratime të pagesave rregullatore. Një përmbledhje e vendimarrjes së Bordit është publikuar pas çdo mbledhje në rrjetet sociale. Ndërsa vendimet e plota gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ERE-s në kategorinë vendimet si dhe në Fletoren Zyrtare.

Procedura të filluara gjatë muajit shkurt 2026

Gjatë muajit shkurt, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) ka filluar procedurën për heqjen e licencave për 9 (nëntë) subjekte ("BRECANI R.O.S.P" shpk, "GERTI" shpk, "HEC TRESKA" shpk, "HYDROPOWER PLANT OF KORCA" shpk, "KORKIS-2009" shpk, "Mountain's Green Energy" shpk, "PESHKU PICAR 1" shpk, "TIRANA ENERGJI" shpk), për shkak se nuk kishin shlyer në afat pagesën e rregullimit për vitin 2025.

Për këto vendime, ERE ka njoftuar vetë shoqëritë, si dhe ka bërë ka publikimet përkatëse në rrjetet sociale, si Instagram, Facebook dhe LinkedIn.

Procedura të filluara gjatë muajit shkurt 2026

Në vijim, pas verifikimit të shmangies nga i licensuari/te licensuarit me poshte, te kushteve qe cuan ne fillimin e procedurave për heqjen e licencave, brenda afatit 30-ditor, Bordi i ERE-s vendosi të përfundojë procedurën dhe të shfuqizojë vendimet e fillimit të procedurës për 7 prej këtyre subjekteve, përkatësisht: "BRECANI R.O.S.P" shpk, "GERTI" shpk, "Mountain's Green Energy" shpk, "TIRANA ENERGJI" shpk, "HEC TRESKA" shpk, "PESHKU PICAR 1" shpk dhe "HYDROPOWERPLANT OF KORCA" shpk

BULETINI INFORMATIV



Procedura licencimi në proces

Gjatë muajit shkurt, Bordi i ERE-s ka vendosur të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë “TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT” sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Vendime licencimi

Gatë muajit shkurt 2026 është licencuar “NOVA SOLAR SYSTEM” shpk në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

Vendime për rinovimin e licencave

Po ashtu, gjatë muajit shkurt Bordi i ERE-s ka vendosur të rinovojë licencat si vijon:

- Licencën e veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike, të shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sha, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 11.06.2026;
- Licencën e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike, të shoqërisë “INFO-Telecom” shpk, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 25.06.2026
- Licencën e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike, të shoqërisë “TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT” shpk, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 25.06.2026.

Vendime për pranimin e kërkesës për heqjen e licencës

Gjatë muajit shkurt 2026, Bordi i ERE-s ka vendosur të pranojë kërkesën e shoqërisë “PROINFINIT CONSULTING” shpk për heqjen e licencave të saj në veprimtarinë e tregtimit dhe atë të furnizimit të energjisë elektrike, për shkak të mosushtrimit të këtyre veprimtarive. Në lidhje me këtë vendimmarrje është njoftuar vetë shoqëria, OST sha, OSSH sha dhe ALPEX sha.

Vendime të tjera

Gjithashtu, gjatë këtij muaji Bordi i ERE-s vendosi në lidhje me konfidencialitetin e dokumentacionit të depozituar nga shoqëria “VOKOPOLA ENERGJI” shpk në kuadër të të licencimit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Aktivitetet e ERE për Konsumatorët

Në Platformën e Krahimit të Çmimeve janë publikuar ofertat e përditesuara nga Furnizuesit e Energjisë elektrike. Krah ofertave të publikuara nga shoqëritë FTL sh.a., NOA Energy Trade sh.p.k. dhe GSA sh.p.k., kanë përditësuar ofertat e tyre sipas niveleve të tensionit edhe shoqëritë ALBESP Trading & Consulting SHPK, dhe Volton shpk; ERE ka marrë dijeni mbi iniciativën e përbashkët të dy operatoreve të rrjetit për hartimin e një dokumenti të ri të Rregullores për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike, i cili vjen në frymën e digjitalizimit të proceseve të aplikimit në Republikën e Shqipërisë. Për këtë qëllim, ERE organizoi një seancë dëgjimore për të marrë shpjegime nga operatorët në lidhje me këtë iniciativë dhe hapat në të cilën ndodhen konkretisht, me qëllim përcjelljen e propozimit në ERE për fillimin e procedurave për shqyrtimin e këtij dokumenti.

BULETINI INFORMATIV

Miratimi i Pagesave Rregullatore për vitin 2026

Në mbledhjen e datës 26.02.2026 Bordi i ERE-s mori vendimin mbi miratimin e pagesave rregullatore për vitin 2026 për të gjithë të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror.

Seanca dëgjimore me palët e interesit

Gjatë muajit shkurt 2026 janë zhvilluar seanca dëgjimore teknike si më poshtë vijon:

- Seancë dëgjimore teknike ndërmjet përfaqësuesve të ERE-s, të shoqërisë KESH sh.a. dhe Furnizuesit të Tregut të Lirë. Në këtë seancë dëgjimore teknike u diskutua mbi kërkesën e shoqërisë KESH sh.a. për marrje mendimi mbi metodologjinë e përcaktimit të tarifës së shërbimit të shkëmbimit/depozitimit të energjisë elektrike.
- Seancë dëgjimore teknike ndërmjet përfaqësuesve të ERE-s dhe shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes. Në këtë seancë dëgjimore teknike u diskutua mbi planin 5 vjeçar të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes për periudhën 2023-2027 nga shoqëria OSSH sh.a.

VENDIME PËR ÇMIMET DHE TARIFAT

Çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit

Në mbledhjen e datës 11.02.2026 Bordi i ERE-s miratoi çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin janar 2026, në vlerën 13.04 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.


Ky çmim rezulton më i ulët krahasuar me muajin dhjetor 2025, i cili ishte 15.98 lekë/kWh.

Çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF) është variabël dhe ndryshon nga muaji në muaj, si pasojë e ndryshimeve në koston e blerjes së energjisë në tregun e lirë për furnizimin e klientëve që marrin shërbimin në kushtet e mundësisë së fundit. Në këtë çmim, kostot e rrjetit dhe kostot administrative mbeten të pandryshuara, ndërsa komponenti kryesor që ndikon në luhatjen është kosto e energjisë së blerë.

Për muajin janar 2026, kosto mesatare e blerjes së energjisë për mbulimin e kërkesës së klientëve të FMF-së ka rezultuar në vlerën 9.30 lekë/kWh, me një sasi të nominuar në bursën e energjisë prej 235.63 MWh. Ndërkohë, për muajin dhjetor 2025, kosto përkatëse ka rezultuar 12.15 lekë/kWh, me një sasi të nominuar prej 130.19 MWh. Në terma krahasues, kosto e blerjes së energjisë për muajin janar 2026 është ulur rreth 23.5% në raport me muajin dhjetor 2025, ndërsa sasia e energjisë së prokuruar për furnizimin e klientëve të lidhur në nivelin e tensionit 35kV është rritur rreth 81%.

Për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV, të cilët furnizohen në kushtet e mundësisë së fundit, çmimi i shitjes së energjisë elektrike mbetet i pandryshuar në nivelin 18.26 lekë/kWh, siç është miratuar nga ERE në muajin shkurt 2026. Ky çmim mbetet fiks, pasi energjia për këtë kategori sigurohet nga KESH sh.a. me të njëjtin çmim për të gjithë vitin 2026. Në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe për të garantuar transparencë ndaj palëve të interesuara, ERE miraton dhe publikon periodikisht çmimin e llogaritur të shitjes së energjisë elektrike nga FMF, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

BULETINI INFORMATIV



AUTORIZIME PËR GARANCI FINANCIARE

Gjatë muajit shkurt 2016, Bordi i ERE-s ka miratuar kërkesat për marrje autorizimi si vijon:

Ndryshim i ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë

Bordi i ERE-s miratoi kërkesën për marrjen e autorizimit për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “PARISOL” shpk, licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 220, datë 23.10.2024, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për Centralin Fotovoltaik me kapacitet 2 MW në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.

Vendosjen e kuotave si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve

Bordi i ERE-s miratoi kërkesën për marrjen e autorizimit për vendosjen e kuotave me qëllim garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj palës kredidhënëse “Raiffesisen Bank” sh.a., për shoqërinë “NOVA SOLAR SYSTEM” shpk, licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 242, datë 03.08.2023, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për Centralin Fotovoltaik me kapacitet 50 MW, në Zonën Kadastrale nr. 3358, Fshati Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier.

Përveç sa më sipër cituar, është vijuar me marrjen e vendimeve sa më poshtë vijon:

Bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën për marrjen e autorizimit për transferimin e aseteve fikse, si mjete për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a, për shoqërinë “NOVA SOLAR SYSTEM shpk licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 242, datë 03.08.2023, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për Centralin Fotovoltaik me kapacitet 50 MW, në Zonën Kadastrale nr. 3358, Fshati Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier.

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 54, datë 17.02.2025 vendosi të shfuqizojë vendimin nr. 304, datë 17.11.2025 mbi kërkesën e shoqërisë “PROINFINIT CONSULTING” shpk për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë. Kërkesë e cila ka ardhur nga vetë shoqëria, e cila ka bërë me dije se nuk është realizuar kalimi i kuotave, për arsye të prishjes së marrëveshjes së shit-blerjes mes palëve.

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 55, datë 17.02.2025 vendosi të mos marrë në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “3AD Energy” shpk në lidhje me marrjen e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të kapitalit si mjet për garantimin e detyrimeve ndaj “First Investment Bank” sha, pasi kontrata e kredisë rezulton e nënshkruar përpara se shoqëria të ishte licencuar nga ERE, e si e tillë përpara se shoqërisë t’i lindte detyrimi për të marrë autorizimin e ERE-s për këtë barrësim.

Publikime dhe përditësime në webfaqe dhe në rrjetet sociale

Gjatë muajit shkurt është përditësuar informacioni në webin e ERE-s www.ere.gov.al dhe rrjetet sociale me vendime, njoftime të mbledhjeve, njoftime mbi aplikime të reja për licencim si dhe çmimet e shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për vitin 2025.

Gjithashtu, në webfaqen e ERE-s gjenden të rifreskuar regjistrat e mëposhtëm:

- Kërkesa dhe përgjigje në Programin e Transparencës ([kliko këtu](#))
- Ankesa të konsumatorëve ([kliko këtu](#))
- Licencime ([kliko këtu](#))
- Autorizime ([kliko këtu](#))
- Procedurat e autorizimit në proces ([kliko këtu](#))
- Procedurat e licencimit në proces ([kliko këtu](#))